



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
24.1.2013, e cila filloi në orën 11:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Ismail Kosumi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Bekim Gashi, Tefik Mehmeti, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Lumnie Rama, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Besa Halimi - Zagragja, Shefqet Sylejmani, Meliza Haradinaj, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja, Afërdita Veliu dhe Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kruesues i Kuvendit.

Fillimisht **kryesuesi** hapi diskutimimin rreth rendit të ditës.

Sadri Ramabaja propozoi që në kuadër të Informatës për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013, të jetë në rend dite edhe shqyrtimi i gjendjes në shkollat e arsimit parauniversitar, konkretisht çështjen e cilësisë në këto shkolla.

Halim Halimi tha se Drejtoria e Arsimit nuk ka mundësi të bëjë analizë rreth asaj se çka ndikon në suksesin ose mos suksesin e nxënësve. Edhe pse jemi munduar, nuk kemi arritur të krijojmë kapacitetet, të cilat drejtpërdrejtë e bëjnë monitorimin e procesit arsimor. Kjo çështje që e shtron profesori, është e drejtë, mirëpo kjo duhet të shtrohet në nivel më të lartë, në nivel të ministrisë, sepse kjo është kompetencë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Naim Makolli propozoi që në rend dite të hyjë çështja e pikëkalimit kufitar në fshatin Mutivodë, fshat i cili i përket rajonit të Malësisë së Gollakut, ndërsa gjendet nën kompetencën territoriale të komunës së Prishtinës. Në këtë pikë kalimi kufitar të funksionalizohet sa më shpejtë shërbimi doganor dhe agjencitë

tjera, me qëllim të ruajtjes së paqes, stabilitetit të brendshëm dhe rajonal të Malësisë së Gollakut, si pjesë e zhvillimit të përgjithshëm duke lehtësuar tregtinë e mallrave, qarkullimin e njerëzve, dhe njëkohësisht mbylljen e kufirit për të gjitha aktivitetet e kundërligjshme. Me këtë kërkesë dua që t'i drejtohem nivelit qendror, që pikëkalimi kufitar i Mutivodës, të përfshihet në Strategjinë e menaxhimit të integruar të kufijve.

Mejreme Berisha ngriti një shqetësim lidhur me emërtimin e sheshit "Zahir Pajaziti", duke kërkuar nga Kuvendi i Komunës edhe nga organet kompetente, veçanërisht nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe nga veteranët e Prishtinës, që sheshi i kryeqytetit tonë të emërtohet sheshi i tre dëshmorëve, i Zahirit, Hakifit dhe i Edmondit.

Shefki Gashi tha se dogana, mbrojtja e kufirit, e sigurisë, harta topografike e shpërndarjes së pozicioneve të ndryshme, nuk janë kompetence e Kuvendit të komunës së Prishtinës, por janë në kompetencë të ministrisë përkatëse.

Aziz Pacolli tha se kërkesa e Naim Makollit duhet të iniciohet prej Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të kërkohej nga niveli qendror caktimi i kufiri edhe në atë pjesë.

Lidhur me kërkesën e z. Makolli, **Kryesuesi** tha se ne solidarizohemi me kërkesën, por nuk është çështje të cilën ne mund ta trajtojmë. Sa i përket çështjes së ngritur nga znj. Berisha, kjo nuk është në kompetence të Kryetarit të Komunës, por janë njerëzit kompetentë dhe shoqatat që duhet të pajtohen të vendosin për këtë çështje.

Për çështjen e ngritur nga z. Ramabaja, rreth cilësisë së arsimit parauniversitar, Po ashtu, ta bëjmë një kërkesë që të ketë një monitorim më të madh nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Me shumicë votash, një abstenim, u konstatua se u miratua ky

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë;
2. Informatë për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2012;
3. Propozimvendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim;
4. Propozimvendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës Rinore dhe programit "Laboratori inovativ"- i UNICEF-it në Prishtinë;
5. Propozimvendimi për dhënien e trafos në shfrytëzim KEK-ut - Distribucionit të shpërndarjes, Njësia në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;

7. Propozimvendimi për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë;
8. Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NLP "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë;
9. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Informatën për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet për periudhën 1 tetor-31 dhjetor 2012, shkurtimisht të pranishmit i informoi **Xhelil Bekteshi**, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, duke cekur se në këtë informatë është pasqyruar buxheti, i cili është i përbërë nga të hyrat vetanake dhe nga grantet. Në pjesën tjetër janë pasqyruar të hyrat vetanake, të cilat janë përfshirë nga fushat e ndryshme, duke filluar prej lejeve ndërtimore e me radhë, deri te të hyrat tjera, andaj kjo është një informatë e thuktë në bazë të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për tremujorin e fundit të vitit 2012.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo është një informatë që tregon rrjedhën e parasë. Në bazë të saj, në bazë të tabelave dhe në bazë të shifrave, vërehet se ka pasur një rrjedhë të mirë, si tek të hyrat vetanake, ashtu edhe te shpenzimet, pra, realisht është tejkaluar përqindja e planifikimit. Por, gjithashtu edhe te shpenzimet vërejmë se ka një tejkalim të kënaqshëm në këtë tremujor të fundit. Si Grup Parlamentarë pajtohemi me këtë informatë.

Aziz Pacolli në emër të GP të AKR-së, tha se ne presim raportin përfundimtar të shpenzimeve vjetore, dhe atëherë do t'i krahasojmë edhe raportet tremujore, që na janë dhënë deri tani, se sa përputhen me raportin përfundimtar.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, tha se po të ishte një angazhim më i shtuar qysh prej fillimit në këtë formë, nuk do të kishin tepruar 18,870,000 €, që i kanë mbetur Komunës pa u shpenzuar për projekte kapitale. Në arsyetimin ku thotë që pjesa më e madhe e investimeve kapitale që është realizuar në këtë periudhë janë infrastruktura rrugore, projekte rurale urbane, do duhej të cekeshin në informatë se cilat janë ato projekte. Gjithashtu theksoi se është shumë shqetësuese te projektet kapitale, se Prishtina ka nevojë për investime

kapitale edhe më të mëdha, pra nga kjo shihet se afro 42- 43% , faktikisht janë mjete të buxhetit që nuk janë shpenzuar.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se këtë informatë e kemi shqyrtuar në KPF. Është tremujori i fundit, pra, siç dihet, në katër pjesë është ndarë planifikimi, gjegjësisht realizimi i këtij buxheti, dhe në bazë të analizave të thukëta, kemi konstatuar dhe konsiderojmë se është shumë i pranueshëm.

Me gjithë vështirësitë e cekura që i kemi pasur, në veçanti në realizimin e disa projekteve, për çka gjithashtu duhen edhe arsye pse ndodhin etj, ne përveç që jemi në mbështetje të këtij raporti, e përgëzojmë edhe Drejtorinë e Financave dhe Pronës dhe Komunën në përgjithësi. Këtë informatë do ta përkrahim.

Shefki Gashi në emër të GP të LDD-së, tha se nga përbindjet që i kam nxjerrë nga kjo informatë del se p.sh. 136% taksa nga lejet e ndërtimit çdo tremujor, prej atyre të planifikuarave 96%, ose shpenzime p.sh. 144%, natyrisht se në periudhën e fundit të vitit rriten shpenzimet, rriten pagesat etj.

Këtë informatë si të tillë, nëse është reale, ne e përkrahim.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se në parim edhe ne do ta përkrahim kështu siç është si informatë, pasi që një informatë më komplete do të jetë më vonë.

Afërdita Veliu, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nga të dhënat e kësaj pasqyre, suficit i bartur i vitit të kaluar, rezulton se kemi një shpërputhje të theksuar në mes të të hyrave vetanake, buxhetit dhe shpenzimeve. Një analizë sipërfaqësore na sjell te përfundimi se këtë vit e kemi përmbyllur me suficit prej mbi 17 milion euro. Pse është fshehur kjo e dhënë në këtë informatë, është çështje e hartuesve. Por, sido qo që të jetë, ky fakt shqetëson shumë, sepse, flet se kjo qeveri nuk është e përgjegjshme me menaxhimin e parasë publike.

Avdullah Hoti tha se në bazë të Statutit të Komunës së Prishtinës dhe Ligjit për menaxhimin e financave publike, është hartuar kjo informatë për shpenzimet për tre muaj, e cila në fakt tregon sa kemi shpenzuar dhe sa kemi arkëtuar gjatë këtij tremujori. Pasqyrat financiare të vitit 2012 nuk janë mbyllur deri më 31 janar, tek atëherë përfundimisht dihet sa janë të hyrat e vitit 2012 për secilin institucion, secilën komunë, dhe sa janë shpenzimet. Ne po i shpenzojmë këto mjete në përputhje me ligjet në fuqi, prandaj ne po bartim suficit nga viti në vit, por jo shkelje dhe keqpërdorim të parasë publike.

Shemsi Veseli konstatoi se ky suficit nuk është vetëm këtë vit, por kjo ka ndodhur edhe viteve të kaluara. Kjo informatë ndryshon prej raportit, se raporti normal votohet, informata nuk votohet, vjen vetëm si informatë. Është dashur ndoshta të jetë edhe më e theksuar, për arsye se kemi të bëjmë me gjendjen ekonomike financiare dhe realizimin e projekteve, dinamikën e tyre, që është dashur të pasqyrohen me disa fjali.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, **Kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

U konstatua se u përkrah Informata për arkëtimin, shpenzimet dhe investimet për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2012.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, tha se

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 04 L - 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe për këtë duhet të formohet një komision vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, i cili, sipas këtij ligji, duhet të përbëhet prej 7 anëtarëve. **Hazir Borovci**, në emër të GP të LDK-së, përkrahu miratimin e këtij propozimi për formimin e këtij komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, u shpreh kundër emërimit të anëtarëve të komisionit njerëz që nuk janë nga komuna e Prishtinës. Në formimin e komisioneve të tilla anëtarët e AKR-së po anashkalohen, megjithatë mendojmë se jemi partia më e madhe opozitare në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, kështu që ne jemi kundër këtij komisioni.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu mendimin e z. Pacolli, duke thënë se edhe ne nuk e votojmë për miratim.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratimin e propozimit.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se derisa nuk paguhen këto komisione, përgjegjësia është zero, autorësia zero, puna është zero, kështu që këtë propozimvendim nuk e përkrahim për miratim.

Feti Mehdiu, në emër të Partisë së Drejtësisë, i përkrahu sugjerimet e parafolësve. Edhe pse me ligj është kështu siç është, edhe për propozimin e z. Pacolli mendoj që ka mundësi të mendohet, edhe për këtë që e tha z. Gashi, megjithatë këtë kështu siç është, e përkrahim dhe ju urojmë sukses.

Sadri Ramabaja në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu mendimin se këto komisione nuk do të duheshin të bëheshin ekskluzivisht vetëm në KPF, edhe për një arsye shtesë, sepse një pjesë prej neve nuk jemi të pranishëm në KPF. Pavarësisht kësaj, ne po e shohim se nuk janë përfillur edhe matematikat politike. Kjo nënkupton se komisionet e kësaj natyre do të duhej në fakt të ishin shprehje e vullnetit politik të këtij Kuvendi, ky që kemi këtu nuk është, prandaj ne abstenojmë.

Me shumicë votash, pesë kundër dhe katër abstenime, u miratua Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për dhënin e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës Rinore dhe programit “Laboratori inovativ”- i UNICEF-it në Prishtinë, shkurtimisht informoi Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, i cili tha se tani janë krijuar kushtet që kësaj qendre t’ia ofrojmë një lokacion, i cili i plotëson standardet për aktivitete kulturore. Po ashtu edhe UNICEF-i është përkrahës i kësaj qendre rinore në programet e saj.

Meliza Haradinaj, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu këtë propozimvendim për dhënie të Strehimores në shfrytëzim Qendrës Rinore dhe Laboratorit inovativ të UNICEF-it. Ky projekt është edhe një platformë e shkëlqyer për aktivitetet rinore dhe një ndër katalizatorët e ndryshimeve shoqërore dhe të aktiviteteve rinore. Deri tash kjo platformë i ka realizuar mbi 41 projekte, të cilat e kanë aktivizuar dhe e kanë përkrahur aktivitetin rinor. Gjithashtu ju ftoj të gjithëve që të angazhohemi dhe të ngemë zërin jo vetëm për Ligjin për Prishtinën, por edhe për Ligjin e rinisë, i cili do t’i kodifikojë të gjitha përgjegjësitë dhe të drejtat që i takojnë kësaj shtrese shoqërore.

Bekim Gashi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim për dhënie të Strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës rinore dhe Laboratorit inovativ të UNICEF-it në Prishtinë. Duke pasur parasysh që Qendra Rinore në Prishtinë deri më tani ka vepruar në një hapësirë jo të përshtatshme për t’i zhvilluar aktivitetet e saj, me këtë vendim, Qendrës Rinore të Prishtinës i krijohet një hapësirë e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve edukative joformale, si dhe veprimtaritë tjera të planifikuara nga të rinjtë. Ne si GP i LDK-së, e përkrahim dhe e mbështesim këtë vendim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, u shpreh në përkrahje të çështjeve që kanë të bëjnë me rininë, që nënkupton se e përkrahjen edhe të këtij propozimvendimi.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, përkrahu këtë propozimvendim, me shpresë që kjo Qendër Rinore nuk do të jetë Qendër e Forumit Rinor të LDK-së, por do të jetë Qendër e rinisë së Prishtinës.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu opinionin se Qendra e Rinisë dhe e Sportit është shndërruar në peng të mafisë, dhe praktikisht niveli qendror dhe ai lokal, nuk mund ta nxjerrin Ligjin e Prishtinës, pa marrëveshje me atë mafi. Kjo qendër që tash po i jepet në dispozicion rinisë, uroj të mos shndërrohet si Pallati i Rinisë.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Ramabaja, Kryesuesi dha sqarime shtesë.

Besa Halimi – Zagragja kërkoi sqarim lidhur me kthimin e strehimores, në rast nevojë, në gjendjen e mëparshme. Le të jetë e rinisë, por mos ta humbë dedikimin që e ka pasur më herët.

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e strehimores publike në shfrytëzim të përkohshëm Qendrës Rinore dhe programit “Laboratori inovativ” i UNICEF-it në Prishtinë.

Pika e pestë

Për Propozimvendimin për dhënien e trafos në shfrytëzim KEK-ut - Distribucionit të shpërndarjes, njësia në Prishtinë, Agim Gashi tha se është propozuar që ky aset t’i jepet në shfrytëzim KEK-ut, në mënyrë që Komuna të shkarkohet me obligimet e ardhshme të mirëmbajtjes dhe procedurave tjera. **Sadri Ramabaja** tha se duhet ta kemi parasysh, sepse dihet që Distribucioni është privatizuar dhe nuk i jepet në pronësi, por në shfrytëzim.

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e trafos në shfrytëzim KEK- ut - Distribucionit të shpërndarjes, Njësia në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Valbon Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, tha se është një kërkesë e kahershme e menaxhmentit të QKMF-së, që Shëndetësia në Prishtinë të ketë një ditë të shënuar.

Kërkesa e menaxhmentit të QKMF-së është që 21 qershori të jetë Dita e Shëndetësisë, pasi që më 21 qershor të vitit 1999, janë rikthyer për herë të parë pas përfundimit të luftës punëtorët shëndetësorë në vendet e tyre të punës.

Musli Mehaj, në emër të GP të LDK-së, tha se ne e kemi analizuar mirë këtë vendim dhe e përkrahim në tërësi, duke sugjeruar që Dita e Shëndetësisë së Prishtinës të jetë në kuptimin e plotë, jo vetëm QKMF-ja, por kjo ditë le të jetë edhe për Qendrën e Mjekësisë Urgjente.

Naim Makolli, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë ndryshim në Statutin e QKMF-së. Megjithatë shprehu një vërejtje, duke thënë se ndoshta është dashur që kjo të kalojë edhe nëpërmjet Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale.

Liridon Restelica në emër të GP të PDK-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Shefqet Sylejmani në emër të GP të AAK-së, e përkrahu këtë propozimvendim për miratim, por me një sugjerim që arsyetimi i këtij vendimi të jetë më i plotësuar.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se kjo datë e cila është propozuar që të jetë Dita e Shëndetësisë, mos ndoshta po e suspendon ekzistimin e dikurshëm të shëndetësisë këtu.

Sadri Ramabaja, në emër të LV, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Njëzëri u miratua vendimi për plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A në Prishtinë, Agim Gashi tha se ky propozimvendim ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pajisjeve, që do të thotë të makinave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve në fushat në të cilat operon Hortikultura.

Vjollca Rizani, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar këtë propozimvendim dhe, duke pasur parasysh nevojat që ka NPL "Hortikultura", vendimi është mjaft i qëlluar, i cili ka të bëjë me ngritjen e cilësisë së mirëmbajtjes të sipërfaqeve publike, sidomos gjatë stinës së dimrit. Si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, shprehu dëshirën që këto mjete të shfrytëzohen për punë, se deri diku e kanë treguar edhe veten se e meritojnë t'ju jepen mjetet që iu nevojiten, andaj dhe e përkrahim këtë vendim për miratim.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu këtë propozimvendim për miratim.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, e përkrahu miratimin e propozimvendimit.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu miratimin e propozimvendimit.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, gjithashtu përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë.

Pika e tetë

Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NPL "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë, në pika të shkurtra informoi **Agim Gashi**, duke cekur se Hortikultura do të subvencionohet me mjete financiare për blerjen e fidanëve dhe mbjelljen e tyre në disa rrugë të Prishtinës.

Vjollca Rizani, në emër të GP të LDK-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Naim Makolli, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë propozimvendim për miratim, por me disa vërejtje. Shihen disa paqartësi në arsyetim, andaj do të donim të dinim se çfarë lloj drurësh dekorativ do të mbillen.

Besa Halimi - Zagragja, në emër të GP të PDK-së, pyeti se a ka pasur proces tenderues, i cili e ka parë atë vlerë, apo është përcaktuar se aq kushton edhe është kryer. Sipas arsytimit, thuhet se këto mjete paskan qenë të dedikuara për rregullimin e ashensorëve, mjete që kanë mbetur pa u shfrytëzuar, e tani po shfrytëzohen për drurë dekorativë. A do të thotë që liftat nuk do të rregullohen dhe pse është bërë bartja e ktyre mjeteve prej atij pozicioni në tjetër pozicion.

Lidhur me vërejtjen e dhënë nga z. Makolli dhe znj. Halimi, **Agim Gashi** dha sqarime të nevojshme.

Abdullah Hoti sqaroi se këto mjete, në shumën prej 300.000 €, shkojnë në llogarinë e NPL "Hortikultura", por kjo ndërmarrje shpall tender në përputhje me Ligjin për prokurim publik dhe prapë e zgjedh ofertën që është më e lira.

Sadri Ramabaja, në emër të LV, shprehu shqetësim rreth këtij propozimvendimi, duke shtuar se ne jemi dëshmitarë se mosmirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara, është halli i kryeqendrës sonë.

Në vitin 2011, rreth 10 hektarë janë mbjellë dhe kultivuar me drurë halorë në kodrat e liqenit të Prishtinës, në bashkëpunim me Komunën, dhe të subvencionuar nga USAID-i. Sot në atë zonë nuk ekzistojnë as edhe 2% të atyre halorëve, të cilët janë shkatërruar, sepse askush nuk është kujdesur për mirëmbajtjen e tyre.

Këtij vendimi i mungon një plan i detajuar se çfarë do të bënte NPL "Hortikultura", do të kishte tender apo jo, u theksua këtu tek pas vërejtjeve për çmimin e lartë etj. Po, r derisa është kjo formë e qeverisjes, respektivisht e keqqeverisjes së parasë publike, duke ridestinuuar vazhdimisht për të gjetur arsyetim, pastaj se pse na kanë mbetur këto të holla të pa shfrytëzuara, kjo është pikërisht ana më shqetësuese. Natyrisht, kjo është arsyeja që ne na bën që të abstenojmë, mos ta votojmë këtë propozimvendim.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu propozimvendimin për subvencionimin e mjeteve financiare, duke propozuar që të shtohet edhe lagjja "Kodra e Diellit", rruga për "Gërmi" dhe lagjja "Vneshtat".

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu miratimin e ropozimvendimit.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Ramabaja, **Avdullah Hoti** dha saqarime të nevojshme.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se parprakisht është dashur të bëhet analiza e tokës së Prishtinës për ata drurë se a i

adaptohen këtyre kushteve për mbjellje, por nëse mbillen, duhet edhe të mirëmbahen. Prishtinës i nevojiten drurë dekorativ më të lirë dhe më ekonomik.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se ne do ta lëmë në përgjegjësinë e ekspertëve, edhe pse çmimi na është dukur se është i lartë. Do ta përkrahim kështu si është, por le të kenë parasysh se mjafton të kultivohet diçka në Prishtinë që qëndron 200 ose 300 vjet, mendoj se mjaft do të ishte.

Me shumicë votash, dy abstenime (Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu), u miratua Vendimi për subvencionimin e mjeteve financiare NLP "Hortikultura" SH.A. në Prishtinë.

Pika e nëntë

Lidhur me Informatën për suksesin e nxënësve në gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013, të pranishmit i njoftoi Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Ai tha se kjo është një informatë, e nuk është analizë, as raport. Informata për suksesin e nxënësve është paraqitur për tri nivele, niveli i parë prej klasës 1-5, niveli i dytë prej klasës 6-9, dhe nivelin e tretë 10-12, përkatësisht 13 arsimit mesëm i lartë. Në këtë informatë është pasqyruar edhe suksesi për të tri nivelet e arsimit, mungesat dhe disa çështje tjera të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen e mësimin gjatë kësaj periudhe.

Ajnishahe Azemi tha se GP i LDK-së e ka analizuar këtë informatë për suksesin e nxënësve në gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2012/2013. Kjo informatë është shumë përmbajtësore, me të dhëna të shumta, të cilat paraqesin një pasqyrë reale të suksesit të arritur në këtë gjysëmvetor, mirëpo mund të konstatojmë se suksesi është pak sa i fryrë, numri i madh i mungesave etj. Nga kjo kemi nxjerrë konstatimin se duhet të gjithë të angazhohemi ta përmirësojmë suksesin në baza reale, në të gjitha nivelet e arsimit. Duhet kërkuar nga Ministria e Arsimit që të formohet numër i mjaftueshëm i grupeve profesionale, të cilat do të bënin monitorimin dhe vlerësimin e arsimit.

GP i LDK-së, informatën e vlerëson shumë pozitivisht.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, shprehu mendimin se në çdo informatë po përsëriten të njëjtat gjëra. Çdoherë po kemi vetëm informatë, asnjëherë nuk po diskutohet seriozisht rreth çështjes së cilësisë së arsimit. Mendoj se obliguesi kryesor për kontrollimin e mësimdhënies dhe mësimdhënësve, është drejtori i shkollës. Për këto gjëra dhe këto informata kisha kërkuar që, në një të ardhme shumë të afërt, të mos jetë vetëm informatë për arsimin, por të jetë çështja e arsimit si pikë e rendit të ditës. Për të luftuar këtë dukuri në arsim, konkretisht për ta luftuar mospunën e mësimdhënësit është niveli lokal.

Kontrolli i parë i mësimdhënësit duhet të jetë stafi i shkollës, në krye me drejtorin e shkollës, pastaj Komuna dhe niveli qendror.

Besa Halimi-Zagragja, në emër të GP të PDK-së, tha se paraprakisht është dashur që të jetë edhe një analizë rreth çështjes së arsimit, sepse vetë rëndësia e temës së arsimit është e tillë. Sa u përket kompetencave se kush çfarë kompetenca ka, ne paraprakisht do të duhej të ndaleshim në atë se a i ka kryer secili detyrat e veta dhe kompetencat. Unë besoj që drejtori i Drejtorisë së Arsimit e bën një plan të punës së tij, dhe këtë plan të punës së tij qoftë vjetor, qoftë më afatgjatë, e bën në bazë të një analize, jo vetëm të infrastrukturës dhe gjërave tjera, por edhe të suksesit, vijueshmërisë, sigurisë, disiplinës dhe shumëçka tjetër. Drejtori i shkollës është vlerësuesi edhe kontrolluesi i parë i mësimdhënësit. Janë shumë faktorë që ndikojnë në mbarëvajtjen e mësimin, si numri i madh i mungesave, dukuri shqetësuese kjo e cila po na përsëritet. Gjithashtu janë shumë çështje e që nuk janë dhënë në informatë, as roli i prindërve, siguria në shkolla, disiplina që është tejet e rëndësishme etj.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se arsimit jo vetëm në komunën tonë, por në tërë Kosovën është në gjendje të rëndë. Për këtë çështje është institucioni më i lartë që duhet të mendojë për këto qendra, shkolla për të gjitha. Megjithatë, problemi në arsim në Kosovë në përgjithësi është në mjerim, por nuk dimë se si ta gjejmë atë zgjidhje. Më dhimbset gjithë arsimit ku njerëzit vërtetë kontribuojnë sa mundet, por kushtet na dirigojnë dhe jemi ku jemi.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se për gjendjen në të cilën gjendet arsimit është për të ardhur keq, andaj kjo është përgjegjësi e të gjithëve. Ne duhet ta hulumtojmë një fenomen që ka ndikuar dukshëm në përqindjen e suksesit të nxënësve në të tri nivelet e arsimit. Çështje tjetër që ndikon në suksesin dhe mbarëvajtjen e mësimin, është edhe kuadri jo profesional, andaj sugjeroj që Drejtoria e Arsimit të marrë masa në këtë drejtim.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, bëri një sugjerim rreth kriterëve për vlerësimin e suksesit të nxënësve. Lidhur me këtë do dëshiroja që kjo të jetë një punë më e vetëdijësuar te arsimtarët, te stafi tjetër që ata ta rrisin suksesin. Numri i madh i mungesave po të krahasohet me notën mesatare, mendoj se nuk është reale. Përderisa ligji e ka hequr inspektionin nëpër shkolla, mendoj se është bërë gabim dhe ligjit duhet t'i bëhen vërejtje, sugjerime, që shkollat të mos lihen pa kurrfarë kontrolli.

Pajtohem me parafolësit që kërkojnë që disiplinën ta bëjmë edhe vetë ne. Gjithashtu duhet të kemi një informatë, apo një analizë që të bëhet në nivel të komunës, çfarë disipline kanë drejtorët, prindërit, nxënësit, dhe pastaj me e përcjell atje lart ku duhet.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se të gjithë jemi të shqetësuar për këtë gjendje, por askush nuk tërheqë paralele se kush ka përgjegjësi. Nga informata shihet qartë se ka rënie të suksesit, siç u potencua, nga cikli në cikël.

Pavarësisht të metave që ka Ligji për arsimin e lartë dhe parauniversitar, ky ligj nuk e amnistion përgjegjësinë e Drejtorisë së Arsimit të komunës sonë. Ligji nuk thotë që në një shkollë, që nga viti 1984 të jetë i njëjti drejtor, edhe po të ishte ai

më i miri i mundshëm, ndërkaq në nivel të shkollave tona, kemi drejtorë të pa përgjegjshëm tërësisht. Drejtorët me mungesë të performancës pozitive, në bazë të ligjit ekzistues, drejtoria mund t'i largojë nga detyra, gjithashtu mund t'i largojë edhe arsimtarët. Sa i përket të dhënave për notën mesatare, shihet se në shkollimin fillor kishim 73.14% të nxënësve me sukses të shkëlqyer, në ciklin e arsimit të mesëm të ultë 30.67% dhe në ciklin e mesëm të lartë shkon në mënyrë katastrofale në 14.7%, shihet se ajo ka një ndryshim shumë të madh. Insistoj që në të gjejmë mënyra të ngarkojmë ekspertë, ta analizojmë situatën në arsim, dhe në një rreth prej mbledhjeve të ardhshme, të dalim me konkluzione konkrete.

Vjollca Dibra-Ibrahimi shprehu mendimin se të gjithë jemi pajtuar për gjendjen e arsimit jo vetëm në nivel komune, por edhe në atë qendror, e cila nuk është aspak e kënaqshme. Pajtohemi me propozimin e z. Ramabaja, që ta mbajmë një seancë për gjendjen e arsimit në komunë dhe të dalim me konkluzione të posaçme dhe me kërkesa që i drejtohem nga ky kuvend edhe nivelit qendror, për ndryshimet që duhet të bëhen urgjentisht në arsim në të gjithë vendin. Sa i përket mungesës së cilësisë, mund të them se kemi edhe problemin e punësimit të stafit të ri. Mendoj se jemi shumë vigjilent dhe jemi duke punuar në këtë drejtim, por do të mundohemi që së bashku, nga kjo seancë e kuvendit, të vendoset për mbajtjen e një seancë të posaçme dhe të nxjerrim konkluzione tjera.

Sofije Kllokoqi tha se kjo informatë ishte e përsëritur ashtu siç ia kanë dorëzuar shkollat. Edhe në Komitetin për arsim shfaqen disa mendime, por ajo që na bënë më së shumti prekje është notimi i ciklit të ulët që qenka i butë, pastaj është zbatueshmëria e trekëndëshit prind-nxënës-mësimdhënës. Ndërsa nëpër shkollat e larta veç bie ai trekëndëshi që duhet me qenë prindi- nxënësi dhe mësimdhënësi. Për mos suksesin e nxënësve mendoj se mësimdhënësi është ai faktori më i madh pastaj prindi që e lenë fëmijun pa një interesim të madh. Po t'i mbajmë orët plotësuese çka është primare dhe shumë e shkëlqyeshme, në përgjithësi dukshëm do të përfitojë suksesi.

Aziz Pacolli ngriti një shqetësim rreth kësaj informate, me ç'rast tha se befason kur drejtori tenton në bazë të ligjit ta mbrojë mos punën e arsimtarit. Mendoj se kjo është një përgjegjësi që ndoshta vjen prej drejtorit të komunës e deri te mësimdhënësi. Kjo është ajo tragjedia më e madhe kur tentohet ligjërisht të mbrohet papunësia e mësimdhënësit.

Naim Makolli tha se të gjitha ato probleme që u cekën rreth mbarëvajtjes së mësimin besoj se nuk i kemi nëpër të gjitha shkollat e Prishtinës.

Unë mundem me thënë me shumë përgjegjësi se një ndër ato shkollat që funksionon shumëçka në rregull dhe që nxirren nxënësit me kapacitet intelektual shumë të mirë është edhe shkolla fillore "Hilmi Rakovica".

Prandaj nuk do të ishte mirë që të diskutojmë kështu në gjenerale gjithçka, duhet t'i shohim edhe gjërat tjera, gjendjen financiare të arsimtarëve etj. që analiza të jetë pak më ndryshe.

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit rreth mbarëvajtjes së mësimit në tre nivelet e arsimit, **Halim Halimi** dha sqarime të nevojshme.

Pika e dhjetë dhe e njëmbëdhjetë Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Astrit Hasani tha se emërimi i rrugëve është aprovuar por ende mungojnë shenjat, numrat dhe hartat e rrugëve. Edhe adresa ime ku unë banojë nuk ka numër. Ju lus që ta merrni në konsideratë kërkesën time që të kryhet kjo punë njëherë mire, sepse jemi kryeqytet dhe duhet të jemi shembull për komunat e tjera.

Po ashtu kam edhe një pyetje për Drejtorin e Arsimit. Pse ende nuk është bërë rrethoja e Shkollës fillore “Xhavit Ahmeti” ku dihet rreziku që i kanoset nxënësve?

Agim Gashi, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim tha se sa i përket shenjzimit ne e kemi kontraktuar një Kompani për vënien e shenjave për emërtimit të rrugëve dhe vendbanimeve, proces i cili ende po vazhdon me disa probleme të vogla teknike që po shfaqen sidomos në rrugët e reja. Sa i përket vënies së numrave, pritet që këtë projekt ta realizon Agjencia Katastrale.

Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit tha se për këtë vit është në projekt rregullimi i rrethojave të shkollës fillore “Xhavit Ahmeti”.

Naime Osmani tha se në seancën e fundit kam parashtruar një pyetje apo të them një kërkesë të qytetarëve që ishte më urgjente ndërsa të tjerat i kam parashtruar me shkrim dhe nuk më është kthyer përgjigje.

Kërkesa është në lidhje me kanalizimin në fshatin Vranidoll në gjatësi prej 100 metrave dhe nuk është intervenuar.

Po ashtu kam bërë pyetje për kanalizimin në Besi për të dy lagjet, si dhe pyetja tjetër ka qenë trotuaret në fshatin Besi brenda fshatit po ashtu edhe përgjatë magjistrales Prishtinë – Podujevë, gjegjësisht deri në udhëkryq në fshatin Besi por jo deri te shkolla. Ndërtimi i këtij trotuari do t’ju mundësonte lëvizje me të sigurt të nxënësve për në shkollë.

Po ashtu kemi kërkuar edhe ndërtimin e një mbi kalimi apo nënkalimi në fshatin Besi. Kërkoj nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale çoftë edhe ajo e Shërbimeve Publike që në këtë drejtim lidhur me këto kërkesa të qytetarëve të më përkrahin apo edhe të më kthejnë përgjigje me shkrim.

Ridvan Shahini drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale tha se kanalizimi gjendet brenda shkollës kurse në Vranidoll është ndërtuar para pesë viteve nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë, dhe ai kanalizim funksionon mirë. Në oborr të shkollës e mirëmban shkolla ose Drejtoria e Arsimit.

Sa i përket trotuareve kërkesat për ndërtimin e tyre janë në Zyrën e Prokurimit

Mejreme Berisha ngiti një shqetësim që kanë ofruar qytetarët e fshatrave të Prishtinës, e që ka të bëjë me Sektorin e bujqësisë duke shtuar se ka qenë një subvencion në fidanishte dhe në bletari. Pjesa dërmuese e atyre fidanëve që janë dedikuar prej Bashkësisë evropiane mbi 80% të atyre që janë mbjell me vonesë në komunën tonë janë tharë edhe përkundër kujdesit për ujitje të vazhdueshme. Edhe pjesa dërmuese e bletëve kanë vdekur pas një muaji. Për këtë çështje pikërisht i drejtohem Sektorit të bujqësisë që të na jepet një përgjigje se çka është në pyetje.

Besa Halimi -Zagragja tha se në Komitetin për arsim është trajtuar çështja e ikjes së nxënësve nga mësimi në kohën e faljes së drekës, dukuri kjo që do duhej të shqyrtohej pak në nivelin e Drejtorisë së Arsimit e pas kësaj duhet të jetë punë edhe për inspeksionin. Gjithashtu në anën tjetër është një ekstremizëm tjetër, p.sh. me rastin e viti të ri mënyra se si kanë reaguar nxënësit që kanë familjet më ekstreme fetare kundër pemës së vitit të ri, kështu që do duhej të ngrihej kjo çështje tek mësimdhënësit ti neutralizojnë dhe të bëjnë diçka në këtë drejtim.

Në anën tjetër nga Komiteti ka dal edhe një kërkesë që kërkon një përgjigje me shkrim që ta dimë njëherë më qartë a ka mundësi të bëhet pagesa e anëtarëve të komiteteve për mënyrë që ato të jenë edhe më funksionale dhe të ndihmojnë edhe punën e këtyre mungesave që janë edhe nëpër drejtori siç e cekim edhe drejtori i arsimit.

Naim Makolli tha se në mbledhjen e fundit kam ngritur disa çështje, kam ngritur edhe çështjen e disa faturimeve të dyfishta që kanë qenë në ujësjellës. Për kërkesën që kam bërë, nga kompania e ujësjellësit "Prishtina" më është kthyer një përgjigje, ku thotë se duhet të sjelli argumente tjera shtesë, për arsye se ujësjellësi thotë se nuk është e vërtetë.

Unë vetëm i kisha propozuar atij ekipit se deklarimet e tyre nuk qëndrojnë dhe se aty vërtetë ka pasur fatura të dyfishta. Çështja tjetër ishte edhe e lidhjes së trafos të dyfishta, ku padrejtësisht qytetarët tanë bien në kategorinë B dhe C. Unë i kam ngritur këto çështje se ne duhet të ju bëjmë një zgjidhje sepse jemi të thirrur në atë drejtim.

Edon Myftari, drejtor i Drejtorisë së Administratës, i njoftoi këshilltarët e Kuvendit, duke cekur se me rastin e kryerjes së punëve zyrtare në Komunë, do të jetë në dispozicion një parking për parkimin e automjeteve private.

Rexhep Mustafa parashtrroi këto pyetje:

Banorët e lagjes "Vellusha" pyesin se çka është me planin e asaj lagje, kur e dimë se para një viti janë dhënë disa vërejtje dhe deri më tani nuk kemi asnjë informatë.

E dyta, banorët e pjesës rurale kanë kërkesë nga inspeksioni që bile një herë apo dy herë në muaj inspektorët të dalin në teren dhe ti vizitojnë fshatrat.

Ka problem me hedhjen e mbeturinave, me hedhjen e dheut aty ku nuk ka kanalizim për ujërat e zeza dhe si pasojë e kësaj mund të vije deri te një konflikt i mundshëm mes banorëve. Kërkoj që inspekcioni duhet të përgatit një fletushkë dhe në mes të çdo fshatit ti njoftojë qytetarët me obligimet që i kanë.

Gjithashtu tjetër problem është edhe ndërtimet që po bëhen buzë rrugëve, mendoj se duhet të informohen qytetarët sa kanë të drejtë apo jo me qitur murin buzë rrugës apo shtëpinë, kur e dimë se rrugët janë shumë të ngushta dhe pengojnë lëvizjen në komunikacionin.

Ajnishahe Azemi parashtrori këto pyetje:

Në emër të qytetarëve për nënkalimin që është në rrugën “Ilir Konushevc” nën hekurudhë dhe në rrugën aty afër në fakt dëshirojnë të dinë se kur do të jetë gati, sepse thuhet se gjendja ekzistuese paraqet rrezik për jetën e qytetarëve.

Tjetra pyetje është në emër të nxënësve të gjimnazit “Xhevdet Doda” po sigurisht edhe qytetarët janë të interesuar për nënkalimin atje në “Lakërishta” kur do të jetë i gatshëm.

Për çështjet e ngritura nga znj. Azemi, sqarime shitesë dha **kryesuesi**.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë **Agim Gashi dhe Ridvan Shahini**.

Mbledhja mbaroi në orën 14:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.